



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

THIRRJE PËR STAF/EKSPERT

Emri: Shoqata Shpresa për të ardhmen
Adresa: Rruga Gjon Gazulli, nr. 64, Shkoder
E-mail: hopeff@hotmail.com
Afati i dorëzimit të ofertës: 13. 07. 2019, ora 16:00

Shoqata Shpresa për të ardhmen po zbaton projektin “Edhe unë e dua librin” në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Bashkia Shkodër, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri, është bashkëfinancuese dhe bashkëzbatuese e programit, për projektet që po zbatohen në territorin e Bashkisë.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata do bleje libra artistikë për të cilat është i nevojshëm staf për shpërndarjen dhe qarkullim të librave mes shkollave të përfshira në projekt të cilat janë në qendër të njësive administrative të Bashkisë Shkodër (Guri i Zi, Velipojë, Ana e Malit, Dajc, Berdicë, Postribë, Rrethina).

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë personat e interesuara duhet të dorëzojnë aplikim e tyre siç parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 13. 07. 2019, ora 16:00, në adresën e e-mail: hopeff@hotmail.com ose në adresën postare: Shoqata Shpresa për të ardhmen, Rruga Gjon Gazulli, nr. 64, Shkodër

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Shoqata Shpresa për të ardhmen do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas përshkrimeve të mëposhtme:

Përshkrimi i punës

Personi i kontraktuar për këtë pozicion punë do kryejë këto detyra: Do kujdeset për shpërndarjen dhe qarkullim e librave mes 7 shkollave të përfshira në projekt: Guri i Zi, Velipojë, Ana e Malit, Dajc, Berdicë, Postribë, Rrethina. Do dorëzojë dhe marrë me inventar librat nga mësuesi i secilës shkollë. Do të raportojë te menaxheri i projektit për punën e bërë. Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën 15 Korrik 2019 -30 Janar 2020. Datat specifike do të përcaktohen në kontratën e lidhur me ekspertin.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Kriteret që duhet të përmbushë eksperti për këtë pozicion:

Eksperti duhet të përmbushë këto kritere:

Të ketë arsimin e lartë në fushën e mësuesisë.

Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune.

I komunikueshëm dhe bashkëpunues.

Preferohet të jetë nga Shkodra dhe të ketë eksperiencë pune me organizatat e shoqërisë civile.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Preferohen persona të fushës së arsimit dhe që nuk janë në marrëdhënie pune në institucionet shtetërore të Bashkisë Shkodër.
- 2) Dorëzimi i aplikimit do të bëhet vetëm nëpërmjet e-mail në adresën e organizatës Shpresa për të ardhmen brenda datës 13. 07. 2019, ora 16:00, ose në adresën postare: Shoqata Shpresa për të ardhmen, Rruga Gjon Gazulli, nr. 64, Shkodër.

Nuk pranohen ofertat dorazi.

- 3) Pagesa e ekspertit do të kryhet me transfertë bankare pas kryerjes së shërbimit.

Në aplikimin e tij/saj, aplikuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit dhe duhet të paraqesin këto dokumenta:

- 1) CV dhe letër interesi;

Aplikanti që ofron shërbimin në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.